



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E POSAÇME E SHKALLËS SË PARË
PËR KORRUPSIONIN DHE KRIMIN E ORGANIZUAR

NJOFTIM PËR MEDIAT

1. Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar me datë **08.01.2026** ka paraqitur pranë Gjykatës kërkesën me objekt: “Dërgimin në gjyq të çështjes penale që i përket procedimit penal numër 196, të vitit 2024, në ngarkim të pandehurve **Benet Beci, Adela Ruko, Edlira Mitrushi, Jonid Kazani, Yllka Nishku, Premtim Dauti dhe Rudin Gjoni**”.

2. Në seancën e datës **17.03.2026** (seanca paraprake), Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar me trup gjykues të përbërë nga gjyqtarja Marinela Osmani, pasi shqyrtoi pretendimet e palëve, me vendimin nr. **63**, datë **17.03.2026**, vendosi:

1. Pranimin e kërkesës së Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar.
2. Dërgimin e çështjes penale që i përket procedimit penal numër 196, të vitit 2024, për gjykim në gjykatën kompetente, Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, në ngarkim të pandehurve:
 1. Benet Beci, akuzuar për kryerjen e veprës penale të "Shkeljes së barazisë së pjesëmarrësve në tendera apo ankande publike", të kryer në bashkëpunim, parashikuar nga nenet 258, 25, të Kodit Penal.
 2. Adela Ruko, akuzuar për kryerjen e veprës penale të "Shkeljes së barazisë së pjesëmarrësve në tendera apo ankande publike", të kryer në bashkëpunim, parashikuar nga nenet 258, 25, të Kodit Penal.
 3. Edlira Mitrushi, akuzuar për kryerjen e veprës penale të "Shkeljes së barazisë së pjesëmarrësve në tendera apo ankande publike", të kryer në bashkëpunim, parashikuar nga nenet 258, 25, të Kodit Penal.
 4. Jonid Kazani, akuzuar për kryerjen e veprës penale të "Shkeljes së barazisë së pjesëmarrësve në tendera apo ankande publike", të kryer në bashkëpunim, parashikuar nga nenet 258, 25, të Kodit Penal.
 5. Yllka Nishku, akuzuar për kryerjen e veprës penale të "Shkeljes së barazisë së pjesëmarrësve në tendera apo ankande publike", të kryer në bashkëpunim, parashikuar nga nenet 258, 25, të Kodit Penal.
 6. Premtim Dauti, akuzuar për kryerjen e veprës penale të "Shkeljes së barazisë së pjesëmarrësve në tendera apo ankande publike", të kryer në bashkëpunim, parashikuar nga nenet 258, 25, të Kodit Penal.

7. Rudin Gjoni, akuzuar për kryerjen e veprës penale të "Shkeljes së barazisë së pjesëmarrësve në tendera apo ankande publike", të kryer në bashkëpunim, parashikuar nga nenet 258, 25, të Kodit Penal.
3. Në bazë të nenit 332/ë të Kodit të Procedurës Penale formimin e fashikullit të gjykimit, i cili përmban të gjitha aktet e kryera gjatë hetimeve paraprake të procedimit penal nr. 196 të vitit 2024, të Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, si dhe ato të marra në seancë paraprake, të paraqitura nga palët dhe të administruara nga gjykata.
4. Së bashku me kërkesën e Prokurorisë së Posaçme për dërgimin e çështjes në gjyq, dërgohen edhe kërkesat e të pandehurve: 1. Benet Beci, 2. Adela Ruko, 3. Edlira Mitrushi, 4. Jonid Kazani, 5. Yllka Nishku dhe 6. Rudin Gjoni, për gjykim të shkurtuar.
5. Kundër vendimit për dërgimin e çështjes në gjyq ligji nuk lejon ankim.

Tiranë, më datë 17.03.2026

Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar